



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:205199  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05743342

**Ac.nr.7069/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. R. nga Prishtina, kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “H. P.”, të cilën me autorizim e përfaqëson S. Th., për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagave për përcjellje në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2379/2020, të datës 19.04.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditurës Universiteti i Prishtinës “H. P.” ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2379/20, të datës 19.04.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2379/2020, të datës 19.04.2021, ka vendosur si vijon: I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. R. me adresë Bregu i Diellit, Rr. ”M. G.”, Llamella 11/9, DETYROHET e paditura Universiteti i Prishtinës “H. P.”, që paditëses M. R. në emër të shpërblimit për tri paga përcjellëse për në pension dhe një paga në emër të shpërblimit jubilar të bashkëshortit të paditëses, tani të ndjerit S. R. t’ia paguaj shumën prej gjithsej 5,638.36 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej datës 19.04.2021, e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. II.DETYROHET e paditura, Universiteti i Prishtinës “H.P.” me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 20.00€.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë anuloj dhe të refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë.

Paditësja nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pabazuar.
- 

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S. R. ka ushtruar padi ndaj të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension. Në padi është paraqitur se ai ka qenë i punësuar si mësimdhënës tek e paditura që nga viti 1978, deri në kohën kur ka arritur moshën e pensionimit me datë 26.11.2018. Ka shtuar se i është drejtuar me kërkesë të paditurës për kompensimin e pagave si në kërkesëpadi, mirëpo nuk janë përgjigjur. Gjatë procedurës, paditësi ka ndërruar jetë, kurse në cilësi të paditëses kishte hyrë bashkëshortja e tij Mevlude Rexhepi. Cilësinë e saj si trashëgimtare e të ndjerit, e kishte vërtetuar përmes aktvendimit të trashëgimisë datë 30.10.2020.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 19.04.2020 dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, pas dëgjimit të palëve në procedurë, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.2379/20, të datës 19.04.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se nuk është kontestuar se paraardhësi i paditëses i ndjeri S. R. ka vdekur me datë 24.07.2020, kjo është vërtetuar edhe nga certifikata e vdekjes 19.2020RV/19001, me nr. rendor 1492 e datës 02.11.2020, po ashtu nuk ka qenë kontestuese se me aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë LRP.nr.4342/2020 REF.nr 0581/2020 të datës 30.10.2020, trashëgimtare e vetme e S. R. është shpallur bashkëshortja e tij M. R., tani paditësja. Gjykata arriti në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar në ligj sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se paraardhësi i paditëses kishte punuar tek e paditura Universiteti Publik “H. P.”, 32 vite, kjo e dokumentuar me Listat e Pagave të muajit korrik, gusht dhe shtator 2019, nga të cilat vërtetohet se paditësi ka 32 vite përvojë të punës tek e paditura dhe të njëjtit nuk i janë paguar pagat për përcjellje në pension dhe për shpërblimin jubilar. Lartësinë e pagës mujore në shumë prej 1,409,59€ neto për muajt korrik dhe gusht dhe shtator të vitit 2019, gjykata e vërtetoi në bazë të listave të pagave për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2019, nga të cilat u vërtetua se paraardhësi i paditëses kishte pranuar pagat mujore në këto shuma.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata është kufizuar në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Ndonëse e paditura nuk ka bërë pretendim të qarë ankimor për sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, ankesa në përmbajtje ka këtë lloj pretendimi. Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase sipas vërtetimeve të të paditurës është vërtetuar se paditësi kishte arritur moshën e pensionimit më datë me datë 06.11.2018, kurse 30 vite përvojë pune i kishte arritur në vitin 2018.

Gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur ta aplikoj drejtë edhe të drejtën materiale. Lidhur me pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për përcjellje në pension duke u mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, kjo gjykatë e gjeti si të pa bazuar. Neni 35 paragrafi 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 ku parashihet që *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”, 9.1. Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë, nga dita e pensionit*”. Kurse për sa i përket pagave jubilarë neni 35 par 8 i të njëjtit akt rregullon se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, ..., për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.”* Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në gjendjen faktike të përshkruar më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagave për përcjellje në pension, dhe një pagë jubilarë, e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike. Kjo ngase referuar dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe nga shkresat e lëndës dhe atë nga lista e pagave për të ndjerin, kjo gjykatë konstaton se vlera e pagës së fundit ka qenë në shumë prej 1,409.59€.

Nga ana tjetër, pretendimi të cilin e ka theksuar e paditura në ankesë se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi për punëmarrësit e saj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pasi që në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Këto situata, eventualisht të disfavorshme për të paditurën nuk mund ti rregulloj as gjykata e as paditësja, si punëmarrëse, e po ashtu kontratat e përgjithshme kolektive mund të parashohin më shumë të drejta për punëmarrësit, përtej ligjeve në fuqi, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë më të disfavorshme për punëdhënësit duke paraparë më pak të drejta se ato që parashihen me ligjet në fuqi.

Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë për sa i përket kamatës, nuk është ndryshuar, ngase nuk kishte ankesë nga pala paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën e nenit 450 të LPK-së dhe me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.7069/2021, datë 23.04.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**